

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Gjirokastrë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- Specialist në Sektorin e Prokurimeve, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike
- Kategoria e pages IV-2

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

29.07.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:
LËVIZJE PARALELE

03.08.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

Specialisti i fushës ose struktura e posaçme kryen detyrat e mëposhtme, sipas rastit:

1. Hartimi i specifikimeve teknike;
2. Përllogaritja e fondit limit;
3. Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik;
4. Hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
5. Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).

6. Në rast se detyrat nuk janë kryer nga specialisti i fushës ose struktura e posaçme, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit/komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, për objektin që prokurohe.
7. Te asistojë në inventarizimin e dosjes.
8. Të jetë pjesë e komisioneve të ndryshme të përcaktuar me urdhër të vecantë nga ana e titullarit të institucionit apo zëvendës titullarit të AK.
9. Siguron transparencën dhe jodiskriminimin gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për mallrat, shërbimet, punët publike dhe investimet e lidhura me to;
10. Realizon brenda afatit të përcaktuar nga ana ligjore të gjitha prokurimet për mallrat, shërbimet, punët publike apo investimet, duke bërë e mundur realizimin e objektivave primare
11. Harton dhe përgatit veçimet për realizim kontrate.

1.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR LEVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e levizjes paralele janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, “Master Shkencor apo Profesional” në fakultetin Juridik, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- a) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 Dokumentacioni, menyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
2. Fotokopje e noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi;
9. Çertifikatë familjare dhe personale;
10. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.07.2026.

1.3 Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit

Në datën 31.07.2026, NJMBNJ do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” si dhe në stendat e Bashkisë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga NJMBNJ, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHA E NJOHURIVE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA

1. Njohuri mbi ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
2. Njohuri mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
3. Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
4. Njohuri mbi Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
5. Vendim nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me vendimin nr. 823, datë 21.10.2020;
6. Udhëzim nr. 07 datë 30.07.2021 Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike;

1.5 MENYRA E VLERESIMIT TE KANDIDATEVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**. Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

5. Vendim nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr. 823, datë 21.10.2020;
6. Udhëzim nr. 07 datë 30.07.2021 Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicioni të punës;
2. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.4 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nëlidhje me:

1. Vlerësimin me shkrim, derinë 60 pikë;
2. Intervistën e strukturuar me gojë konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, derinë 15 pikë.

2.5 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJMBNJ do të shpallë fituesin në stendën e Bashkisë dhe portalin e "Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail)

DREJTOR

Mirlinda Shabani

